



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 219 Prot.

Tiranë, më datë 30.03.2022

VENDIM

Nr. 62, datë 30.03.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 30.03.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Kalaja e Bashtovës”, Monument Kulture i kategorisë së I-rë, në kuadër të projektit “Rijetëzimi i siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri”, me aplikues dhe projektues të licencuar për ndërhyrje në pasuri kulturore personi juridik “Atelier 4” sh.p.k. dhe zhvillues “Zyrat UNOPS në Shqipëri” dhe Konceptit të Sondazheve Arkeologjike të hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Iris Pojani;
 2. Sondazhet arkeologjike do të kryhen krahas me zbatimin e punimeve të restaurimit, duke lidhur akt-marrëveshje tre-palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji;
 3. Rezultati i sondazheve arkeologjike duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
 5. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara të dokumentacionit teknik pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 7. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

